



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 27.02.2023

Nr: 09

Ora: 12:15

**VENDIM**

**PËR PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS NR. 06, DATË 17.02.2023 TË  
KOMISIONERIT SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 27.02.2023, me pjesëmarrjen e:

<b>Elvis ÇEFA</b>	-	<b>Relator</b>
<b>Elvin LAKO</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ilirjan RUSMALI</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Koli BELE</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ledio BRAHO</b>	-	<b>Anëtar</b>

Shqyrtoi çështjen me:

**KËRKUES:** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

**OBJEKT:** Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ ndaj zj. Arisa Toska, Sekretar i Përgjithshëm i Bashkisë Berat, për mosraportim të veprimtarive publike brenda afatit ligjor

**BAZË LIGJORE:**

Nenet 21/dh, 126, dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të nenit 17, neni 34, shkronja “b” dhe neni 35 të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator, “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

**VËREN:**

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka depozituar pranë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve kërkesën për vënie sanksioni, e cila është regjistruar në regjistrin e kërkesave për masat disiplinore, me nr. 06 regj., datë 17.02.2023. Në mbledhjen e datës 27.02.2023, ora 12:15, pas relatimit të z. Elvis Çefa u konstatua se kërkesa i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 35 të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve” dhe në mbështetje të nenit 45, pika 1, shkronja “c”, kërkesa ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

**PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 129, pika 3, shkronja “a”, 130 dhe 131 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KAS-i

**V E N D O S I:**

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës nr. 06, datë 17.02.2023 të paraqitur nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve;
2. Shqyrtimi do të bëhet në datën 28.02.2023 ora 12:45;

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Vendimi është i formës së prerë dhe nuk mund të bëhet ankim.

**Elvis ÇEFA** - **Relator**

**Elvin LAKO** - **Anëtar**

**Ilirjan RUSMALI** - **Anëtar**

**Koli BELE** - **Anëtar**

**Ledio BRAHO** - **Anëtar**